

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhimi i Performancës

P8

Nr.

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data
Date

16.10.2022

CONTENT / PËRMBAJTJA

SESSION	MAXIMUM ASSIGNED	<u>-ATTENTION!</u> <u>THIS PART IS</u> <u>FOR SCAAK</u> <u>USE ONLY-</u> MARKS
1. Problem 1	20	
2. Problem 2	20	
3. Problem 3	20	
Part a.	10	
Part b.	10	
4. Problem 4	20	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Pjesa	Maksimumi i dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë</u> <u>është vetëm për</u> <u>përdorim nga</u> <u>ShKÇAK-</u> PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
Pjesa a.	10	
Pjesa b.	10	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Punëtorja 'Kutia' bënë prodhimin e pajisjeve për përdorim shtëpiak nga dërrasat. Lënda e parë e përdorur në procesin e prodhimit kryesisht pranohet në formë gjysmë të përpunuar nga rrjeti i gjerë i furnitorëve të shumtë. Punëtorët kryesisht bëjnë montimin e pjesëve të parafabrikuara në produkte të dimensioneve të ndryshme, intervenime me anë të makinerisë për dhënie të formave të llojllojshme dhe ngjyrosjen e produkteve. Të dhënat për tre produktet kryesore të punëtorisë për tremujorin e tretë të këtij viti janë në vijim:

		<u>Alfa</u>	<u>Beta</u>	<u>Gama</u>
Prodhimtaria	njësi	2,500	2,000	500
Çmimi i shitjes	€/njësi	50	35	115
Kosto e materialit direkt (MD)	€/njësi	6	8	15
Orët e punës direkte (PD)	orë	2	1	5
Kosto e punës direkte	€/orë	6	6	6

Gjatë periudhës së njëjtë janë llogaritur shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (ShPP-të) sipas aktiviteteve me të dhënat për faktorët nxitës përkatës si më poshtë:

<u>Aktiviteti</u>	<u>€</u>	<u>Faktori nxitës</u>	<u>Alfa</u>	<u>Beta</u>	<u>Gama</u>
Kostot e organizimit	54,000	Numri i organizimeve	20	25	5
Kostot e pranimit të MD	16,500	Numri i porosive të pranuar	20	20	4
Kostot e shpërndarjes	27,000	Numri i dërgesave të bëra	30	20	10
Kostot e orëve të makinerisë	45,000	Orët e makinerisë për njësi	2	1	6

Kërkohet:

- Llogaritni koston dhe fitimin për njësi të produkteve Alfa, Beta dhe Gama sipas koston përveçuese bazuar në orët e punës direkte; **6 pikë**
- Llogaritni koston dhe fitimin për njësi të produkteve Alfa, Beta dhe Gama sipas koston së bazuar në veprimtari (ABC); **14 pikë**

Zgjidhja

- Llogaritja e koston dhe fitimit për njësi të produkteve Alfa, Beta dhe Gama sipas koston përveçuese bazuar në orët e punës direkte:

Llogaritja e normës së përveçimit të ShPP-së – Formula

$$\text{Norma e përveçimit të ShPP-së} = \text{ShPP e buxhetuar} \div \text{Niveli i buxhetuar orëve të PD}$$

ShPP e buxhetuar

<u>Lloji i koston</u>	<u>Vlera (€)</u>
Kostot e organizimit	54,000
Kostot e pranimit të MD	16,500
Kostot e shpërndarjes	27,000
Kostot e orëve të makinerisë	<u>45,000</u>
ShPP e buxhetuar	142,500

½ pikë

Orët totale të buxhetuara të Punës Direkte (PD)

<u>Produkti</u>	<u>Njësi</u>	<u>Orë/njësi</u>	<u>Totali i orëve</u>	
Produkti Alfa	2,500	2	5,000	
Produkti Beta	2,000	1	2,000	
Produkti Gama	500	5	<u>2,500</u>	
Totali i orëve të PD:			9,500	1½ pikë

Norma e përvetësimit të ShPP-së = €142,500 ÷ 9,500 orë të PD

= **€15.00** për orë të PD **1 pikë**

Llogaritja e kostos dhe fitimit për njësi

<u>Kartela e kostos</u>	<u>Alfa</u>	<u>Beta</u>	<u>Gama</u>	
Kostoja e MD	6.00	8.00	15.00	
Kostoja e PD (€6 ×2 orë; ×1 orë; ×5 orë)	12.00	6.00	30.00	
ShPP e përvetësuar (€15 ×2 ; ×1 ; ×5)	<u>30.00</u>	<u>15.00</u>	<u>75.00</u>	
Kostoja totale për njësi	48.00	29.00	120.00	1½ pikë
Çmimi i shitjes	<u>50.00</u>	<u>35.00</u>	<u>115.00</u>	
Fitimi / Humbja për njësi	2.00	6.00	-5.00	1½ pikë

- b. Llogaritja e kostos dhe fitimit për njësi të produkteve Alfa, Beta dhe Gama sipas kostos së bazuar në veprimtari (ABC):

Llogaritja e normës së përvetësimit të veprimtarive – Formula

Norma e përvetësimit të veprimtarisë = ShPP e buxhetuar ÷ Niveli i buxhetuar i veprimtarisë

<u>Veprimtaria</u>	<u>Kostot</u>	<u>Numri i</u>	<u>Norma e përvetësimit</u>	
Organizimet	54,000	50	1,080.00	1 pikë
Pranimi i materialeve direkte	16,500	44	375.00	1 pikë
Shpërndarja	27,000	60	450.00	1 pikë
Orët e makinerisë	45,000	10,000	4.50	1 pikë

Llogaritja e ShPP-së (të përvetësuar) të veprimtarisë për njësi:

<u>Veprimtaria</u>		<u>Alfa</u>	<u>Beta</u>	<u>Gama</u>	
Kostot e organizimit	1,080 × 20	21,600			1½ pikë
	× 25		27,000		
	× 5			5,400	
Kostot e pranimit të MD	375 ×20	7,500			1½ pikë
	×20		7,500		
	×4			1,500	
Kostot e shpërndarjes	450 ×30	13,500			1½ pikë
	×20		9,000		
	×10			4,500	
Kostot e orëve të makinerisë	4.5 × 2,500 ×2	<u>22,500</u>			1½ pikë
	× 2,000 ×1		<u>9,000</u>		
	× 500 ×6			<u>13,500</u>	
Totali i ShPP-së së përvetësuar		65,100	52,500	24,900	
Njësitë e prodhuara		<u>2,500</u>	<u>2,000</u>	<u>500</u>	
ShPP e përvetësuar për njësi		26.04	26.25	49.80	1½ pikë

Llogaritja e kostos dhe fitimit për njësi

<u>Kartela e kostos</u>	<u>Alfa</u>	<u>Beta</u>	<u>Gama</u>	
Kostoja e MD	6.00	8.00	15.00	
Kostoja e PD (€6 ×2 orë; ×1 orë; ×5 orë)	12.00	6.00	30.00	
ShPP e përvetësuar	<u>26.04</u>	<u>26.25</u>	<u>49.80</u>	
<i>Kostoja totale për njësi</i>	44.04	40.25	94.80	1 pikë
Çmimi i shitjes	<u>50.00</u>	<u>35.00</u>	<u>115.00</u>	
Fitimi / Humbja për njësi	5.96	-5.25	20.20	1½ pikë

Problemi 2

Punëtorja 'Kutia' e prodhon Produktin Delta në dy versione Delta.Pro dhe Delta.Max. Për prodhimin e këtyre produkteve gjatë muajit tetor të këtij viti Punëtorja disponon me 900m² të materialeve direkte (dërrasave) dhe 400 orë të punës direkte. Kontabilisti menaxherial i punëtorisë ka nxjerrë të dhënat në vazhdim për të dy versionet e këtij produkti:

		<u>Delta.Pro</u>	<u>Delta.Max</u>
Materialet Direkte (MD)	m ²	9	15
Puna Direkte (PD)	orë	5	5
Kontributi	€	6	9
Kërkesa	njësi	E pakufizuar	40

Ai gjithashtu ka ardhur në përfundim se për të maksimizuar fitimin mujor nga këto produkte duhet të prodhohen dhe shitën 50 njësi të produktit Delta.Pro dhe 30 njësi të produktit Delta.Max.

Kërkohet:

- Të llogaritet vlera e kontributit maksimal që Punëtorja 'Kutia' mund të realizoi bazuar në numrin e njërive që duhet të prodhohen dhe shitën sipas llogarive të bëra nga kontabilisti menaxherial. **2 pikë**
- Të llogaritet mos-/ mbi-shfrytëzimi për secilin prej burimeve apo faktorëve kufizues (materialit direkt, punës direkte dhe kërkesës). **6 pikë**
- Çfarë është çmimi hije (çmimi dual)? Të llogaritet çmimi hije për secilin prej burimeve apo faktorëve kufizues (materialit direkt, punës direkte dhe kërkesës). **12 pikë**

Zgjidhja

- Llogaritja e kontributit maksimal bazuar në prodhimin dhe shitjen e 50 njërive të produktit Delta.Pro dhe 30 njërive të produktit Delta.Max.

$$\text{Kontributi(max)} = 6x + 9y$$

Ku, $x = 50$ njësi të produktit Delta.Pro dhe

$$y = 30 \text{ njësi të produktit Delta.Max}$$

$$\text{Kontributi(max)} = (\text{€}6 \times 50) + (\text{€}9 \times 30)$$

$$= \text{€}300.00 + \text{€}270.00$$

$$= \underline{\underline{\text{€}570.00}}$$

2 pikë

- Llogaritja e mos-/ mbi-shfrytëzimit të secilit burim apo faktori kufizues

– Materiali

$$\text{Disponueshmëria} = 900 \text{ m}^2$$

$$\text{Shfrytëzimi:} = (50 \text{ njësi} \times 9 \text{ m}^2) + (30 \text{ njësi} \times 15 \text{ m}^2)$$

$$= (450 \text{ m}^2 + 450 \text{ m}^2)$$

$$= 900 \text{ m}^2$$

$$\underline{\underline{\text{Disponueshmëria} = \text{Shfrytëzimin}}}$$

Nuk ka mos-/ mbi-shfrytëzim. Kufizimi është lidhës.

2 pikë

– Puna

$$\text{Disponueshmëria} = 400 \text{ orë}$$

$$\begin{aligned}\text{Shfrytëzimi:} &= (50 \text{ njësi} \times 5.0 \text{ orë}) + (30 \text{ njësi} \times 5.0 \text{ orë}) \\ &= (250 \text{ orë} + 150 \text{ orë}) \\ &= 400 \text{ orë}\end{aligned}$$

$$\text{Disponueshmëria} = \text{Shfrytëzimin}$$

Nuk ka mos-/mbi-shfrytëzim. Kufizimi është lidhës.

2 pikë

– Kërkesa 50 njësi të produktit Delta.Pro *Nuk ka kufizim*

½ pikë

– Kërkesa 30 njësi të produktit Delta.Max 40 njësi

Kontributi (max) arrihet me 30 njësi

Mos-shfrytëzimi i kërkesës **10 njësi**

Mos-shfrytëzimi i kërkesës për produktin Delta.Max 10 njësi

1½ pikë

c. Çmimi hije (çmimi dual) i një faktori kufizues është shuma e ndryshimit në vlerën e funksionit objektiv (për shembull, rritja e kontributit), e krijuar nga disponueshmëria e një njësie shtesë të burimit kufizues me koston e tij fillestare

2 pikë

Nëse kemi në dispozicion 1 m² me shumë të materialit atëherë kufizimi do të jetë:

$$9x + 15y = 901.0 \text{ m}^2$$

½ pikë

Kontributi maksimal:

$$9x + 15y = 901 \quad (1)$$

$$5x + 5y = 400 \quad (2)$$

$$(1) \times 5 \quad 45x + 75y = 4,505 \quad (3)$$

$$(2) \times 9 \quad 45x + 45y = 3,600 \quad (4)$$

$$(3) - (4) \quad 30y = 605$$

$$y = 30.17$$

Nëse zëvendësojmë $y = 30.17$ në ekuacionin (1) atëherë:

$$9x + (15 \times 30.17) = 901$$

$$9x = 901 - 452.5$$

$$9x = 448.5$$

$$x = 448.5 \div 9$$

$$x = 49.83$$

$$\text{Kontributi(max)} = 6x + 9y$$

$$= (6 \times 49.83) + (9 \times 30.17)$$

$$= 299.0 + 271.5$$

$$\text{Kontributi(max)} = \underline{570.5}$$

3 pikë

Nëse kemi në dispozicion 1orë me shumë të punës atëherë kufizimi do të jetë:

$$5x + 5y = 401 \text{ orë}$$

1/2 pikë

Kontributi maksimal:

$$9x + 15y = 900 \quad (1)$$

$$5x + 5y = 400 \quad (2)$$

$$(1) \times 5 \quad 45x + 75y = 4,500 \quad (3)$$

$$(2) \times 9 \quad 45x + 45y = 3,609 \quad (4)$$

$$(3) - (4) \quad 30y = 891$$

$$y = 29.70$$

Nëse zëvendësojmë $y = 29.70$ në ekuacionin (1) atëherë:

$$9x + (15 \times 29.70) = 900$$

$$9x = 900 - 445.5$$

$$9x = 454.5$$

$$x = 454.5 \div 9$$

$$x = 50.5$$

$$\begin{aligned} \text{Kontributi(max)} &= 6x + 9y \\ &= (6 \times 50.5) + (9 \times 29.7) \\ &= 303.0 + 267.3 \end{aligned}$$

$$\text{Kontributi(max)} = 570.3$$

3 pikë

Çmimi hije i metrit katror (m^2) shtesë të materialit:

$$\text{Kontributi me } 1 \text{ m}^2 \text{ shtesë të materialit} \quad 570.50$$

$$\text{Kontributi bazë} \quad \underline{570.00}$$

$$\text{Çmimi hije i m}^2 \text{ shtesë të materialit} \quad \mathbf{0.50}$$

1 pikë

Çmimi hije i orës shtesë të punës:

$$\text{Kontributi me } 1 \text{ orë shtesë të punës} \quad 570.30$$

$$\text{Kontributi bazë} \quad \underline{570.00}$$

$$\text{Çmimi hije i orës shtesë të punës} \quad \mathbf{0.30}$$

1 pikë

Çmimi hije i kërkesës për produktin Delta.Pro nuk kemi, sepse aty nuk kemi kufizim të kërkesës.

1/2 pikë

Çmimi hije i kërkesës për produktin Delta.Max është 0, sepse aty kemi mos-shfrytëzim të kërkesës.

1/2 pikë

Problemi 3

- a. Kompania 'Kutia' prodhon Produktin Omega cilin e shet me çmimin prej €76.00 për njësi. Prodhimtaria e buxhetuar është 72,000 njësi në vit që paraqet 90% të kapacitetit. Kompania ka mundësinë të bëjë angazhimin e kapaciteteve të pashfrytëzuara duke e shitë produktin e saj një blerësi i cili ofron çmimin maksimal të blerjes prej €55.00.

Kostot e përgjithshme të buxhetuara janë në vlerën prej €4,320,000 prej të cilave kosto të përgjithshme të buxhetuara fikse janë 30%.

Kërkohet:

- Llogaritni koston totale fikse dhe variabile të Produktit Omega për nivelin aktual të prodhimit. 5 pikë
- Bazuar në të dhënat të cilat janë në dispozicion, a duhet Kompania 'Kutia' të pranoi ofertën e bërë nga blerësi? 5 pikë

- b. Kompania 'Integrali' prodhon komponentët Ben, Bon, Bun për transmetuesin Motion i cili përdoret nga kompania për shpërndarjen kabllorë të programeve televizive. Deri në fund të vitit kompania duhet të bëjë shtrirjen e rrjetit kabllor në lagjen e re të kryeqytetit.

Për prodhimin e komponentëve Ben, Bon dhe Bun të cilat montohen në transmetues, Kompania përdorë makinerinë e njëjtë dhe komponentët prodhohen vetëm nga një lloj përgjatë periudhës. Deri në fund të periudhës, kompania ka në dispozicion vetëm 34,000 orë të makinerisë që janë të pamjaftueshme për prodhimin dhe montimin e komponentëve në transmetues. Për tejkalimin e problemit dhe përmbushjen e marrëveshjes, kompania duhet të bëjë blerjen e disa komponentëve.

Pas regjistrimit të stoqeve të komponentëve, kontabilistit menaxherial të kompanisë i ofrohen shënimet në të cilat tregohet mungesa e komponentëve sipas llojit dhe të dhënat tjera si vijon:

<u>Komponenti</u>	<u>Ben</u>	<u>Bon</u>	<u>Bun</u>
Kërkesa (numri i njësive që mungojnë)	4,000	8,000	7,500
Kosto variabile të prodhimit dhe montimit për njësi	25	18	20
Çmimi i blerjes të komponentëve (€ për njësi)	40	32	35
Orët e kërkuara për prodhimin dhe montimin e komponentit	5	2	3

Kërkohet:

Menaxhmenti kërkon nga kontabilisti menaxherial i kompanisë që të bëjë planin se cilat komponente Kompania duhet të bëjë (prodhojë) vet dhe cilat të blejë që do të rezultojë me kursimet më të larta (rrjedhimisht koston më të ultë) të kompanisë? 10 pikë

Zgjidhja

- 3.a.i. Llogaritja e koston totale fise dhe variabile të Produktit Omega për nivelin aktual të prodhimit

Shitjet (€76.0 × 72,000 njësi)	€5,472,000	
Kostot e përgjithshme variabile (L12)	<u>€3,024,000</u>	
Kontributi	€2,448,000	
Kostot e përgjithshme fikse (L11)	<u>€1,296,000</u>	
Fitimi	€1,152,000	2 pikë

Llogaritjet:

(L1)	Kostot e përgjithshme të buxhetuara	€4,320,000	
	Përqindja e kostove fikse	<u>30%</u>	
	Kostot e përgjithshme fikse (€4,320,000 × 30%)	€1,296,000	1 pikë
(L2)	Kostot e përgjithshme të buxhetuara	€3,825,000	
	Kosto të përgjithshme të buxhetuara fikse	<u>€1,296,000</u>	
	Kostot e përgjithshme variable	€3,024,000	1 pikë
	Numri i njësive	<u>÷ 72,000</u>	
	Kosto variable për njësi	€42	1 pikë

3.a.ii. Analiza e ofertës së bërë nga blerësi

	Numri aktual i njësive	72,000	
	Përqindja aktuale e shfrytëzimit të kapaciteteve	<u>÷ 90%</u>	
	Kapaciteti i plotë i kompanisë (njësi)	80,000	1 pikë
	Kapaciteti i shfrytëzuar aktual (njësi)	<u>72,000</u>	
	Kapaciteti i pa-shfrytëzuar (njësi)	8,000	1 pikë

Kompania ka në dispozicion për t'i ofruar blerësit 8,000 njësi.

	Shitjet shtesë (8,000 njësi × €55)	€440,000	
	Kostot variable shtesë (8,000 njësi × €42)	<u>€336,000</u>	
	Kontributi shtesë	€104,000	
	Kostot fikse (janë të mbuluara)	<u>€0</u>	
	Fitimi shtesë	€104,000	2 pikë

Po, bazuar në efektet financiare të ofertës Kompania duhet të pranoi ofertën pasi që kjo do t'i sjell fitim shtesë prej €104,000. **1 pikë**

3.b. Bëje (prodhoje) apo blejë

Përcaktimi i planit të prodhimit dhe blerjes që do të rezultojë me kursimet më të larta (rrjedhimisht koston më të ultë) të kompanisë.

	<u>Ben</u>	<u>Bon</u>	<u>Bun</u>	
Kostoja variable e 'bërjes' (prodhimit)	25	18	20	
Kostoja variable e 'blerjes'	<u>40</u>	<u>32</u>	<u>35</u>	
Kostoja shtesë variable e blerjes (kontributi për njësi)	15	14	15	1½ pikë
Shfrytëzimi i burimit kufizues (orët e makinerisë)	<u>5</u>	<u>2</u>	<u>3</u>	
Kontributi për njësi të burimit kufizues	3	7	5	1½ pikë
Prioriteti për prodhimtarinë e brendshme	I treti	I pari	I dyti	1½ pikë

Plani i prodhimit (bëje)

<u>Renditja</u>	<u>Produkti</u>	<u>Njësi për t'u prodhuar</u>	<u>Orë për njësi</u>	<u>Totali i orëve</u>	
I pari	Bon	8,000	2	16,000	½ pikë
I dyti	Bun	Balanca	6,000	<u>3</u>	1½ pikë
				34,000	1 pikë

Plani i blerës

<u>Renditja</u>	<u>Produkti</u>	<u>Njësi për t'u blerë</u>	
I dyti	Bun	Sasia e mbetur	1,500
I treti	Ben		4,000

1½ pikë
1 pikë

Problemi 4

Kompania 'Kutia' ka zhvilluar kartela e kostos standarde për prodhimin e një njësie të produktit Sigma, për nivelin e buxhetuar prej 2,000 njësive, i cili shitet me çmimin prej €350 për njësi është llogaritur mbi këtë bazë:

	<u>Sasia</u>	<u>Çmimi</u>	<u>Vlera</u>
Materialet e drejtpërdrejta (MD)	25	6.0	150
Puna e drejtpërdrejtë (PD)	8	5.0	40
ShPP variabile	8	5.0	40
ShPP fikse	8	4.0	32

Kompania përdor sistemin e kostos përvetësuese dhe ShPP-në e përvetëson në bazë të orëve të PD. Kompania i vlerëson stoqet sipas kostos standarde dhe nuk ka stoqe fillestare të produktit Sigma.

Në fund të periudhës, pas prodhimit të 1,950 njësive të Produktit Sigma, rezultatet aktuale të prodhimitarisë ishin si më poshtë:

	<u>Sasia</u>	<u>Çmimi</u>	<u>Vlera</u>
Materialet e drejtpërdrejta (MD)	46,800	6.20	290,160
Puna e drejtpërdrejtë (PD)	16,000	4.80	76,800
ShPP variabile			76,500
ShPP fikse			55,000

Nga shitjet e realizuara të produktit Sigma janë gjeneruar €648,000 ndërsa stoqet përfundimtare të produktit Sigma ishin 150 njësi.

Kërkohet:

Të përgatitet pasqyra e operacioneve për produktin Sigma sipas sistemit të kostos përvetësuese. Pasqyra duhet të tregojë të gjitha mospërputhjet e shitjeve, materialeve, punës, ShPP-së variabile, ShPP-së fikse dhe duhet të barazojë fitimin neto të buxhetuar me fitim neto aktual.

20 pikë

Zgjidhja

Llogaritja e të gjitha mospërputhjeve bazë:

▪ Mospërputhjet e shitjes:

- Mospërputhja e vëllimit të shitjes

$$(\text{Shitjet e buxhetuara} - \text{Shitjet aktuale}) \times \text{Fitimi standard}$$

$$(2,000 - 1,800) \times (\text{€}350 - \text{€}262)$$

17,600 PF

- Mospërputhja e çmimit të shitjes

$$\text{Shitjet aktuale} \times (\text{Çmimi aktual} - \text{Çmimi standard})$$

$$1,800 \times [(\text{€}648,000 \div 1,800) - 350]$$

18,000 F 2 pikë

- Mospërputhjet e materialeve:
 - Mospërputhja e përdorimit të MD (për njësitë e prodhuara)
(Përdorimi standard i MD – Përdorimi aktual i MD) × Çmimi standard
[(1,950 × 25 kg) – 46,800 kg] × €6.0 11,700 F
 - Mospërputhja e çmimit të MD (për sasinë aktuale të përdorur)
Përdorimi aktual i MD × (Çmimi standard – Çmimi aktual)
46,800 kg × (€6.0 - €6.2) 9,360 PF 2 pikë
- Mospërputhjet e punës:
 - Mospërputhja e efikasitetit të PD (për njësitë e prodhuara)
(Orët standarde të PD – Orët aktuale të PD) × Norma standarde e PD
[(1,950 × 8 orë) – 16,000 orë] × €5.0 2,000 PF
 - Mospërputhja e normës së PD (për orët aktuale të punuara)
Orët aktuale të PD × (Norma standarde e PD – Norma aktuale e PD)
16,000 orë × (€5.0 - €4.8) 3,200 F 2 pikë
- Mospërputhjet e ShPP-së variabile:
 - Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së variabile
ShPP variabile e buxhetuar – ShPP variabile aktuale
€80,000 - €76,500 3,500 F
 - Mospërputhja e efikasitetit të ShPP-së variabile (për njësitë e prodhuara)
(Orët standarde të PD – Orët aktuale të PD) × Norma standarde e ShPP-së variabile
[(1,950 × 8 orë) – 16,000 orë] × €5.0 2,000 PF 2 pikë
- Mospërputhjet e ShPP-së fikse:
 - Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së fikse
ShPP fikse e buxhetuar – ShPP fikse aktuale
€64,000 - €55,000 9,000 F
 - Mospërputhja e vëllimit të ShPP-së fikse
 - Mospërputhja e vëllimit të efikasitetit të ShPP-së fikse (për njësitë e prodhuara)
(Orët standarde të PD – Orët aktuale të PD) × Norma standarde e ShPP-së fikse
[(1,950 × 8 orë) – 16,000 orë] × €4.0 1,600 PF
 - Mospërputhja e vëllimit të kapacitetit të ShPP-së fikse
(Orët e buxhetuara të PD – Orët aktuale të PD) × Norma standarde e ShPP-së fikse
(16,000 orë – 16,000 orë) × €4.0 0 F 3 pikë

Llogaritja e fitimit të buxhetuar (standard) neto - sipas sistemit përvetësues

Shitjet	2,000 × €350	€700,000
Kostot		
Materialet e drejtpërdrejta (MD)	2,000 × 25 kg × €6.0	€300,000
Puna e drejtpërdrejtë (PD)	2,000 × 8 orë × €5.0	€80,000
ShPP variabile	2,000 × 8 orë × €5.0	€80,000
ShPP fikse	2,000 × 8 orë × €4.0	€64,000
Totali i kostove		€524,000
Fitimi neto i buxhetuar (standard)		€176,000

ose

$$\begin{aligned}
 \text{Fitimi neto i buxhetuar (standard)} &= \text{Numri i buxhetuar i njësive} \times (\text{Çmimi i shitjes për njësi} - \text{Kostot totale për njësi}) \\
 &= 2,000 \times [€350 - (€150 + €40 + €40 + €32)] \\
 &= 2,000 \times (€350 - €262) \\
 &= 2,000 \times €88 \\
 &= \mathbf{€176,000}
 \end{aligned}$$

2 pikë

Pasqyra e operacioneve për Produktin P sipas sistemit të kostos përvetësuese

Fitimi neto i buxhetuar (standard)			€176,000
<u>Mospërputhjet e shitjes</u>	<u>Favorshme</u>	<u>Pafavorshme</u>	
Mospërputhja e vëllimit të shitjes		€17,600	
Mospërputhja e çmimit të shitjes	€18,000		
Totali i mospërputhjeve të shitjes	€18,000	€17,600	€400
<u>Mospërputhjet e kostove të prodhimitarisë</u>			
Mospërputhja e përdorimit të MD	€11,700		
Mospërputhja e çmimit të MD		€9,360	
Mospërputhja e efikasitetit të PD		€2,000	
Mospërputhja e normës së PD	€3,200		
Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së variabile	€3,500		
Mospërputhja e efikasitetit të ShPP-së variabile		€2,000	
Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së fikse	€9,000		
Mospërputhja e vëllimit të efikasitetit të ShPP-së fikse		€1,600	
Mospërputhja e vëllimit të kapacitetit të ShPP-së fikse	€0		
Totali i mospërputhjeve të kostove të prodhimitarisë	€27,400	€14,960	€12,440
Fitimi aktual neto			€188,840

7 pikë

Prova:

Llogaritja e fitimit aktual

Shitjet	1,800 × €360	€648,000
Kostot e prodhimitarisë		
Materialet e drejtpërdrejta (MD)	46,800 kg × €6.2	€290,160
Puna e drejtpërdrejtë (PD)	16,000 orë × €4.8	€76,800
ShPP variabile		€76,500
ShPP fikse		€55,000
Totali i kostove të prodhimitarisë		€498,460
Minus: Stoqet përfundimtare	150 njësi × €262	€39,300
Kostot e shitjes		€459,160
Fitimi neto i buxhetuar (standard)		€188,840

Problemi 5

Kompania 'Kutia' përdorur metodën e të ardhurave të mbetura (RI - e ardhura nga teprica) për matjen e performancës së fitimit të divizioneve të saja. Norma minimale e kthimit që ngarkon kompania për pasuritë qarkulluese të angazhuara është 5%, ndërsa për pasuritë fikse të angazhuara është 10%. Më poshtë janë të listuara disa të dhëna financiare për tri divizionet e Kompanisë 'Kutia'.

<u>Të dhënat e buxhetuara</u>	<u>Divizioni A</u>	<u>Divizioni B</u>	<u>Divizioni C</u>
Fitimi i buxhetuar	250,000	140,000	125,000
Pasuria qarkulluese e buxhetuar	300,000	525,000	750,000
Pasuria fikse e buxhetuar	900,000	825,000	975,000

<u>Të dhënat aktuale</u>	<u>Divizioni A</u>	<u>Divizioni B</u>	<u>Divizioni C</u>
Fitimi aktual	220,000	185,000	125,000
Pasuria qarkulluese	275,000	480,000	825,000
Pasuria fikse	900,000	875,000	990,000

Kërkohe:

- Llogarisni Kthimin e buxhetuar në Investime (ROI e buxhetuar) dhe të Ardhurën e mbetur të buxhetuar (RI e buxhetuar) për secilin divizion. **9 pikë**
- Llogarisni Kthimin aktual në Investime (ROI aktuale) të Ardhurën e mbetur aktuale (RI aktuale) për secilin divizion. **9 pikë**
- Llogarisni ndryshimin e ROI të buxhetuar dhe ROI aktuale dhe ndryshimin e RI të buxhetuar dhe RI aktuale për secilin divizion krahasuar. **2 pikë**

Zgjidhja

a. ROI (Kthimi në investime) i buxhetuar

<u>Të dhënat e buxhetuara</u>	<u>Divizioni A</u>	<u>Divizioni B</u>	<u>Divizioni C</u>
Fitimi i buxhetuar	250,000	140,000	125,000
Pasuria qarkulluese e buxhetuar	300,000	525,000	750,000
Pasuria fikse e buxhetuar	<u>900,000</u>	<u>825,000</u>	<u>975,000</u>
Gjithsej pasuria e buxhetuar	1,200,000	1,350,000	1,725,000
ROI = (Fitimi ÷ Gjithsej pasuria) × 100	20.83%	10.37%	7.25%

3 pikë

RI (e ardhura e mbetur) e buxhetuar

<u>Të dhënat e buxhetuara</u>	<u>Divizioni A</u>	<u>Divizioni B</u>	<u>Divizioni C</u>
Fitimi i buxhetuar	250,000	140,000	125,000
Kthimi minimal - P. qarkulluese (L1)	15,000	26,250	37,500
Kthimi minimal - P. fikse (L2)	<u>90,000</u>	<u>82,500</u>	<u>97,500</u>
Gjithsej kthimi minimal	105,000	108,750	135,000
RI = Fitimi - gjithsej kthimi minimal	145,000	31,250	-10,000

L1 Kthimi minimal (P. qarkulluese) = Pasuria qarkulluese × Norma minimale e kthimit
 = €300,000 × 5% = €525,000 × 5% = 750,000 × 5%
 = €15,000 = €26,250 = €37,500

L2 Kthimi minimal (P. fikse) = Pasuria fikse × Norma minimale e kthimit
 = €900,000 × 10% = €825,000 × 10% = €975,000 × 10%
 = €90,000 = €82,500 = €97,500 **6 pikë**

b. ROI (Kthimi në investime) aktual

<u>Të dhënat aktuale</u>	<u>Divizioni A</u>	<u>Divizioni B</u>	<u>Divizioni C</u>
Fitimi aktual	220,000	185,000	125,000
Pasuria qarkulluese aktuale	275,000	480,000	825,000
Pasuria fikse aktuale	<u>900,000</u>	<u>875,000</u>	<u>990,000</u>
Gjithsej pasuria aktuale	1,175,000	1,355,000	1,815,000
ROI = (Fitimi ÷ Gjithsej pasuria) × 100	18.72%	13.65%	6.89%

3 pikë**RI (e ardhura e mbetur) aktuale**

<u>Të dhënat aktuale</u>	<u>Divizioni A</u>	<u>Divizioni B</u>	<u>Divizioni C</u>
Fitimi aktual	220,000	185,000	125,000
Kthimi minimal - P. qarkulluese (L13)	13,750	24,000	41,250
Kthimi minimal - P. fikse (L14)	<u>90,000</u>	<u>87,500</u>	<u>99,000</u>
Gjithsej kthimi minimal	103,750	111,500	140,250
RI = Fitimi - gjithsej kthimi minimal	116,250	73,500	-15,250

L13 Kthimi minimal (P. qarkulluese) = Pasuria qarkulluese × Norma minimale e kthimit
= €275,000 × 5% = €480,000 × 5% = 825,000 × 5%
= €13,750 = €24,000 = €41,250

L14 Kthimi minimal (P. fikse) = Pasuria fikse × Norma minimale e kthimit
= €900,000 × 10% = €875,000 × 10% = €990,000 × 10%
= €90,000 = €87,500 = €99,000

6 pikë**c. Ndryshimi në mes të dhënave të buxhetuara dhe rezultateve aktuale**

<u>Ndryshimi</u>	<u>Divizioni A</u>	<u>Divizioni B</u>	<u>Divizioni C</u>
ROI (Kthimi në investime) i buxhetuar	20.83%	10.37%	7.25%
ROI (Kthimi në investime) aktual	<u>18.72%</u>	<u>13.65%</u>	<u>6.89%</u>
	-2.11%	3.28%	-0.36%
RI (e ardhura e mbetur) e buxhetuar	145,000	31,250	-10,000
RI (e ardhura e mbetur) aktuale	<u>116,250</u>	<u>73,500</u>	<u>-15,250</u>
	-28,750	42,250	-5,250

1 pikë**1 pikë**